



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 102 Datë 18.10 2010

**Për dhënien e mendimit të ushtrimit të veprimtarisë “ Plus Communication“
Sh. A në territorin e Bashkisë Korçë.**

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve ,bazuar në nenin 32 pika K të ligjit nr.8652 date 31.07.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “ , në mbështetje të nenit 102 të kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit 8990,datë 23.01.2003“ Për vlerësimin e ndikimit në mjedis“ dhe të VKM nr.249 “ Për miratimin e dokumentacionit për lejëmjedisoredhe të elemntëve mjedisore“ si dhe në udhëzimin i ministrit të mjedisit ,pyjeve dhe administrimit te ujrave nr.2,datë,29.06.2010 “ Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar lejë mjedisore .

VENDOSI :

1. Të lejojë ushtrimin e veprimtarisë të ketij subjekti në territorin e Bashkisë Korçë.
2. Ky vendim do të depozitohet nga Subjekti “ Plus Communication“ Sh.A në Q.K.L si një nga dokumentat ligjore për marrjen e Lejes Mjedisore.
3. Ky vendim hyj ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI